

Raporti tremujor janar-mars 2008

20.06.2008

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në tremujorin e parë të vitit 2008 në kuadër të prioritetëve të përcaktuara ka rishqyrtuar strukturën organizative ekzistuese, duke përfshirë edhe institucionet dhe ka propozuar një strukturë të re të organizimit, e cila do të sigurojë funksionimin efikas të ministrisë, administratës dhe institucioneve në kuadër të ministrisë.

Legjislacioni

Është aprovuar nga Qeveria, Ligji për ansamblin kombëtar të këngëve dhe valleve “Shota” dhe Ligji për Sponsorime;

Projektligjit për Fuqizimin dhe Pjesëmarrjen e Rinisë ka kaluar leximin e parë dhe pritet të aprovohet në mbledhjen e ardhshme të Qeverisë dhe të procedohet më tutje në Kuvend;

Hartimi i akteve nënligjore dhe rregulloreve përkatëse nga Ligji për Trashëgimi Kulturorë

Bazuar në Ligjin e Qendrës Kinematografike të Kosovës, Ministri ka emëruar Bordin prej pesë anëtarëve për funksionalizimin e punës në këtë institucion dhe ka themeluar Fondin për Qendrën Kinematografike.

Këshilli i librit ka miratuar rregulloren e punës së Këshillit dhe ka filluar shqyrtimin e Projekt rregullore për licencim dhe regjistrim të botuesve në Kosovë.

Janë përfunduar procedurat për themelimin e Këshillit Kombëtar të Bibliotekave. Në këtë kuadër janë përfunduar shtatë statutet e bibliotekave ndërkomunale, që funksionojnë në kuadër të Ministrisë.

Gjatë kësaj periudhe është bërë edhe licencimi i federatave të sportit konform Udhëzimit Administrativ nr. 02/2005, ku janë licencuar 14 federata të sportit.

Investimet kapitale

Projekti për rekonstruimin e objektit: Teqja e Hasit në Lubizhdë, punët janë përfundim e sipër, vlera e kontratës është 102,430.00 €

Projekti për rekonstruimin dhe rregullimin e kompleksit: Varrezat e Martireve në Çabrat – Gjakovë, projekti është duke u zbatuar, kurse vlera e kontratës është 49,853.64 euro. Në përgatitje për publikim janë tenderët për projektet:

Restaurimi dhe konservimi i Kullës së Sahatit në Gjakovë; Rekonstruimi i Shtëpisë Jashar Pashës në Pejë; restaurimi dhe konservimi i Muzeut Arkeologjik në Prizren; Projekti për sanimin e urës së Zallqit në Istog.

Në fushën e sportit ka filluar zbatimi i projektit: renovimi i palestrave ekzistuese (Ferizaj, Gjilan, Pejë dhe Mitrovicë), vlera e kontratës për renovimin e palestrave 64,767.18 € Ka filluar zbatimi i projektit: faza e parë e ndërtimit të palestrës sportive në Drenas, vlera e kontratës është 279,106.45 € Fillimi i punimeve për ndërtimin e palestrës sportive në Istog, vlera e kontratës 334,385.20 € Përfundimi i punimeve-faza e tretë, në palestrën sportive në Podujevë, shuma me të cilën participon Ministria është 100,000.00 euro.

Departamenti i Kulturës

Trashëgimia kulturore

Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë dhe Institutit Arkeologjik Gjerman, përfaqësuar nga Komisioni Gjermano- Romak (RGC) për Incizimet gjeofizike në lokalitetet arkeologjike – Ulpiana, Gllamnik; ka përfunduar Incizimi gjeofizik i arealit në Gllamnik-Podujevë, në bashkëpunim me ekspertët gjerman. Në vazhdimësi po realizohen punimet në objektet e Investimeve kapitale të bartura nga viti 2007; Në bashkëpunim me Ambasadën Britanike dhe CHWB është duke u realizuar projekti i bazës së të dhënave për trashëgiminë kulturore në Kosovë.

Divizioni i Arteve SkenikoMuzikore dhe Pamore

Teatri Kombëtar i Kosovës realizoi një premierë "Liria po vjenë", të autorit Milazim Krasniqi, në regji të Agim Selimit dhe një shfaqje premierë "Mysafire Daja Vanja" e realizuar në bashkëpunim me aktorët e Kosovës, Maqedonisë dhe të Shqipërisë.

Filarmonia – Opera e Kosovës realizoi 4 projekte. Orkestra dhe kori i Filarmonisë-Operës së Kosovës realizoi koncertin memorial në Teatrin Kombëtar në Prishtinë me rastin e dy-vjetorit të vdekjes së Presidentit dr. Ibrahim Rugova, koncert që u realizua nën patronatin e Presidencës së Kosovës; Më 17.02.2008, orkestra simfonike dhe Kori Profesional i Filarmonisë-Operës së Kosovës realizoi koncertin artistik solemn në ditën e shpalljes së pavarësisë së Kosovës nën patronatin e Qeverisë së Kosovës – në sallën 1 Tetori në Prishtinë.

Më 06.03.2008, Orkestra simfonike e dhe Kori Profesional i Filarmonisë-Operës së Kosovës realizoi koncertin artistik në Akademinë përkujtimore kushtuar manifestimit tradicional Epopeja e UÇK-së dhe shënimit të 10- vjetorit të rënies heroike të Komandantin Legjendar Adem Jashari, mbajtur në sallën 1 Tetori në Prishtinë nën patronatin e Kryeministrit të Kosovës, z. Hashim Thaçi.

Më 30.03.2008, Orkestra Simfonike e Filarmonisë-Operës së Kosovës realizoi koncertin e rregullt artistik të muajit mars, sipas planit vjetor të punës, në Sallën e Kuqe të Pallatit të Rinisë në Prishtinë.

Ansambli i Baletit, gjatë kësaj periudhe ka realizuar gjashtë paraqitje skenike, nga reportoari i shfaqjeve të realizuara më parë.

Teatri Profesionist i Gjakovës gjatë kësaj periudhe ka shfaqur një shfaqje reprizë dhe ka organizuar 2 shfaqje mysafire;

Teatri Profesionist i Gjilanit, ka realizuar Festivalin e Dramës Kombëtare “ Talia e Flakës 2008”, në kuadër të “ Flakës së Janarit”; dhe një shfaqje;

Teatri Profesionist i Prizrenit, ka realizuar katër repriza të shfaqjeve, prej të cilave dy shfaqje në Prizren dhe dy të tjera në Gjakovë dhe në Pejë, si dhe ka organizuar 2 shfaqje mysafire;

Teatri Profesionist i Pejës ka reprizuar 13 shfaqje, një nga Teatri Dodona dhe një nga Teatri Profesionist i Prizrenit, po ashtu në Teatrin e Pejës janë mbajtur 2 koncerte të muzikës klasike dhe kamertale me artistë të Kosovës. Ky teatër shënon “ 100 vjetorin e Artit Skenik të Pejës”.

Galeria e Arteve të Kosovës, në këtë periudhë ka organizuar 6 ekspozita: Ekspozita kushtuar 10-vjetorit të vdekjes së Mulsim Mulliqit; Ekspozita personale e Ymer Shaqirit; program i veçantë – Maratona e videoartit me rastin e Ditës së Pavarësisë; ekspozita e artistes nga Finlanda Ritva Luukkanen; Epopeja e UÇK-së “Përkujtimi artistik” Ekspozita personale e Driton Hajredinit. Galeria e Ministrisë “QAFA”, gjatë kësaj periudhe ka organizuar dhe realizuar tri ekspozita individuale të artistëve.

Ansamblu kombëtar i këngëve dhe valleve “SHOTA”, gjatë kësaj periudhe ka realizuar dy shfaqje koncertale, duke marrë pjesë në Ditën e Pavarësisë së Kosovës me këngë dhe valle si dhe në Prekaz me rastin e shënimit të 10- vjetorit të rënies heroike të Komandantit Legjendar Adem Jashari;

Divizioni i Promovimit

Ka përkrahur një sërë projektsh, është angazhuar në mbarëvajtjen e aktiviteteve kulturore, multikulturore të Kosovës, shtimin e fondit librar në bibliotekat ndërkomunale me arritjen e bashkëpunimeve të ndryshme, organizimin e trajnimeve të punonjësve të bibliotekave; pjesëmarrja në promovimin e programit “Athens” (Bibl. Elektronike) në BKUK.

Zyra për Publikime

Është miratuar dhe shpallur konkursi për përkrahje të dy revistave kulturore. Është bërë shpallja e konkursit për vepër origjinale, të traditës dhe të përkthyer. Në Këshill janë mbështetur edhe disa projekte si ajo e “Karvanit të Shkrimtarëve për Fëmijë” në kuadër të cilit do të shënohet edhe Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve, projekt - kërkesa e Bejtullah Destanit për librin e Arthur Evans “Lidhja Shqiptare e Prizrenit” në gjuhën angleze, për panairin e librit në Prishtinë. Në këtë periudhë janë përfunduar procedurat dhe janë dhënë nga Ministri: Çmimi Kombëtar “Azem Shkreli”, për vepër jetësore në letërsi akademik Enver Gjerçekut dhe Dr. Agim Devës për vepër më të mirë të vitit paraprak në letërsi.

Departamenti i Rinisë.

Programi për Integrim Social dhe Pjesëmarrje të Rinisë (SIP-fondi), në bashkëpunim me GTZ dhe UNV ka realizuar zbatimin e SIP-fondit me c' rast pas shpalljes së ftesës për aplikim janë pranuar 54 projekte, ku pas vlerësimit të komisionit kanë përfituar 22 organizata, nga to 11 projekte me vlerë 15.000.00 € janë mbështetur nga Departamenti i Rinisë, ndërsa 11 projekte tjera me vlerë prej 15.000.00 janë mbështetur nga GTZ. Nga to 4 projekte janë OJQ-të e komitetit serb, ndërsa të tjerat po ashtu kanë karakter shumetnik dhe multidisiplinor.

Në vazhdim është duke u bërë realizimi i projektit; Përkrahja e Vullnetarëve të OKB-së në zbatimin e Planit Kosovar të Veprimit për Rini, është përkrahur financiarisht nga UNDP-ja. Nga ky program kanë përfituar 11 organizata për ngritjen e vetëdijes tek të rinjtë lidhur me tematikat e mijëvjeçarit, siç i ka vlerësuar OKB-ja dhe të cilat janë pjesë e PVRK-së, dhe këto aktivitete janë mbështetur me 31,656 Euro; Fillimi i krijimit të këshillave të veprimit për rini gjatë këtyre muajve ka vazhduar zbatimin e projektit në fjalë i cili mbështet financiarisht nga UNICEF-i dhe realizohet në bashkëpunim me rrjetet rinore, kuvendet komunale dhe OJQ-të relevante. Mbështetur nga Banka Botërore, Departamenti i Rinisë është duke bërë përmirësimin e punës dhe qëndrueshmërisë së qendrave ekzistuese rinore. Gjatë kësaj periudhe janë mbështetur 10 qendra rinore në kompletimin e inventarit si dhe plotësimin e disa kërkesave të tjera. Në mesin e këtyre qendrave, të cilat kanë përfituar, janë 3 qendra rinore, që i përkasin komunitetit serb. Departamenti i Rinisë është angazhuar edhe në hartimin e projekteve që lidhen me parandalimin e pPirjes së duhanit (me rastin e 31 Majit - Ditës Ndërkombëtare Kundër Duhanit).

Departamenti i Rinisë në bashkëpunim me MPMS-në dhe MASHT-in i kanë prezantuar Komisionit Evropian (fondet e IPA-s) projektin „Promovimi i Punësimit përmes aftësive profesionale dhe trajnimeve në kKompani,, projekt i cili ndihmon realizimin e strategjisë së punësimit. Mbështetur nga Banka Botërore për personelin e Departamentit të Rinisë janë zhvilluar një sër trajnimesh si: menaxhimi i ciklit të projekteve, menaxhimi i ekipeve, zhvillimi i politikave, monitorimi dhe vlerësimi, të cilat do të ndihmojnë në ngritjen e kapaciteteve menaxhuese.

Departmenti i Sportit

Mbështetur në planin e punës, përkatësisht prioritetet - Departamenti i Sportit ka kryer këto aktivitete: hartimi i politikave programore, duke bërë plotësimet dhe ndryshimet e nevojshme dhe duke caktuar prioritetet e tij për vitin 2008. Në këtë kontekst janë është ndarë buxheti për këto politika programore: 1) Sporti i femrave; 2) Mjekësia sportive (buxhetohet me rishikim); 3) sporti i të rinjve; 4) ndërkombëtarizimi i sportit; 5) infrastruktura e sportit; 6) sporti dedikuar minoriteteve; 7) Sporti dedikuar personave me aftësi të kufizuara dhe, 8) Zhvillimi i kapaciteteve menaxhuese në federatat e sportit. Departamenti i Sportit ka mbështetur në vazhdimësi projektet dhe aktivitetet e federatave të sportit, ashtu si edhe përkrahjen e tyre në drejtim të bashkëpunimit me institucionet rajonale, mbarëkombëtare dhe ndërkombëtare. Do të realizohen takimet e planifikuara të përfaqësuesve zyrtarë të federatave sportive të Kosovës me përfaqësuesit zyrtarë të fderatave sportive të Shqipërisë, përmes ftesës zyrtare që ka bërë KOKSH (Komiteti Olimpik Kombëtar i Shqipërisë) në adresë të KOK (Komitetit Olimpik të Kosovës).

Në kuadër të këtij udhëtimit të organizuar (datë 28 mars 2008) është paraparë edhe nënshkrimi i marrëveshjeve reciproke të bashkëpunimit, me çka do të sigurohet përkrahja e nevojshme në aspektin e ndërkombëtarizimit të sportit të Kosovës.

Infrastruktura e sportit

Gjatë muajit shkurt dhe mars janë bërë vizita nëpër komuna ku janë planifikuar të bëhen investime kapitale, përfshirë drejtoritë komunale në Mitrovicë, Drenas, Istog, Rahovec, Prizren, Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, si dhe janë vizituar edhe komunat Therandë, Vushtrri dhe Lipjan.

Zyra për Integritet Evropian

Në zbatimin e Planit të Veprimit të Partneritetit Evropian, dy prioritete të larta janë në përgjegjësi të MKRS: Trashëgimia Kulturore dhe Prona Intelektuale. Zyra për Integritet Evropian ka koordinuar dhe monitoruar dinamikën e zbatimit të PVPE-së ndërsa për kryerjen e veprimeve të identifikuar në plan, Divizioni i Trashëgimisë Kulturore është autoritet përgjegjës, ndërsa për administrimin e veprimeve të MKRS për pronën intelektuale ZIE në MKRS vazhdon me përgatitjen e infrastrukturës ligjre dhe administrative deri në themelimin e Zyrës për të drejtat e autorit e cila do të marrë përgjegjësitë nga Plani i Veprimit për Partneritet Evropian (PVPE). Analiza e raportit të nëntorit të Komisionit Evropian për Kosovën me theks të veçantë në vërejtjet e Komisionit për fushat që mbulon MKRS në kuadër të Planit për Partneritet Evropian 2006. Vërejtjet e identifikuar në raport kanë ndihmuar në caktimin e veprimeve në planin e ri për vitin 2008. Në fushën e të drejtave të autorit është hartuar pjesa më e madhe e dokumenteve administrative për funksionalizimin e Zyrës për të drejtat e autorit. MKRS në bashkëpunim me Ministrinë e Industrisë dhe Tregtisë ka dhënë kontribut në hartimin e strategjisë për Pronën Intelektuale Në ngritjen e kapaciteteve për Integritet evropian MKRS ka marrë pjesë në trajnimet e Qeverisë dhe në programe të tjera.

Njëherit ka përfituar edhe nga programi CBIE, është duke zhvilluar kontaktet me TAIEX-in dhe njëkohësisht është përfituese e Programit IPA në fushën e trashëgimisë kulturore dhe në politikat aktive për punësimin të rinjëve. MKRS-ja nëpërmjet ZIE dhe institucioneve përgjegjëse për fushat prioriare ka marrë pjesë dhe ka kontribuar në hartimin e Planit të Veprimit për Partneritet Evropian 2008. Të gjitha vërejtjet e Komisionit Evropian nga raporti i nëntorit 2007 janë marrë në konsideratë, gjendja aktuale dhe përvojat gjatë implementimit të planit të mëparshëm. Sfidat kryesore për periudhën e ardhshme është fuqizimi i institucioneve përgjegjëse për zbatimin e veprimeve nga Plani i Veprimit për Partneritet Evropian 2008.

Njësia për të Drejtat e Njeriut

Aktivitetet kryesore: Promovimi i drejtave të njeriut, dhënia e kontributit për hartimin e Programit të Kosovës për barazi gjinore, pjesëmarrja në grupin punues për shqyrtimin e rekomandimeve të Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës për Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Minoriteteve, pjesëmarrja në grupin punues të Qeverisë së Kosovës për parandalimin e antitrafikimit, Organizimi i dy punëtorive për pjesëtarët e Shërbimit Policor të Kosovës, arritja e marrëveshjes në mes të MKRS-së dhe Organizatës Ndërkombëtare për Migrim

(IOM) për implementimin e projektit “Parandalimi i Trafikimit dhe Vetëdijesimi i Qytetarëve në Kosovë” Ministria ka krijuar bashkëpunim të ngushtë me Ombudspersonin dhe zyrtarët e tij përmes korrespondencës së rregullt dhe takimeve sipas nevojës për shqyrtimin e rekomandimeve të ombudspersonit. Ministria gjithashtu është duke implemtuar në tërësi Ligjin për Qasje në Dokumente Zyrtare.

Departamenti i Administratës Qendrore

Zbatimi i udhëzimit administrativ nr: MSHP 2006/10 për rregullat dhe procedurat e punës së njësisë për monitorimin e përdorimit të gjuhëve zyrtare në institucionet qendrore të Kosovës; zbatimi i udhëzimit administrativ nr: 09/2007 për dorëzim –pranimin e lëndës arkivore; zbatimit të udhëzimit administrativ nr: 04/2008 për përdorimin e telefonave {fiks dhe mobil} në Qeverinë e Kosovës; zbatimit të vendimit nr: 11/20008, përdorimit të logos së Qeverisë së Kosovës; Zbatimi i udhëzimit administrativ nr: 07/2008. përdorimi i vulave.

Spektori i financave

Spektori i financave është angazhuar në përgatitjet e buxhetit për vitin 2008, si dhe në relacion me auditorët e jashtëm, të cilët tashmë kanë përfunduar punën në ministrinë tonë. Spektori i financave ka menaxhuar në vazhdimësi shpenzimin e buxhetit, dhe ka informuar në kohën e duhur departamentet dhe institucionet për udhëzimet administrative të reja të lëshuara nga MEF-i. që kanë të bëjnë me realizimin e obligimeve të vitit të kaluar, si dhe shpenzimin e buxhetit për vitin 2008. Buxheti i aprovuar i Ministrisë për vitin 2008 është 9,048,201.00 euro ku për përudhen tre mujore janar-mars, janë shpenzuar 15.92%.